

VENDIM
Nr.685, datë 5.10.2011

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.391, DATË 1.6.2011 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË
“NXITJA E BIZNESIT SOCIAL”, SHA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 8 të ligjit nr.10 376, datë 10.2.2011 “Për krijimin e shoqërisë “Nxitja e biznesit social”, sh.a.”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në statutin e shoqërisë “Nxitja e biznesit social”, sh.a., që i bashkëlidhet vendimit nr.391, datë 1.6.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në nenin 5 “Kapitali”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 formulohet, si më poshtë vijon:

“2. Në çastin e themelimit, shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministri i Financave, kontribuon në para, në kapitalin e shoqërisë, me një shumë prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, e cila përbën kapitalin fillestar të shoqërisë. Kjo shumë do të përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për vitin 2011.”.

b) Në pikën 3, fjalët “...Ministria e Financave...” zëvendësohen me “...Ministri i Financave...”.

2. Pas pikës 2 të nenit 8, “Rritja e kapitalit”, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Kontributi i shtetit shqiptar për rritjen e kapitalit të shoqërisë do të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha